



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 71, Datë 10.05.2019**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “POWER AND  
GAS OPERATIONS” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 pika 2, gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”; nenit 5, pika 1 gërma “e”; nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.05.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi kërkesën e shoqërisë “Power and Gas Operations” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “Power and Gas Operations” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 308 Prot., datë 23.04.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
- Aplikimi i shoqërisë “Power and Gas Operations” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
  - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 2, gërma “a”(akti i themelimit), gërma “e“, (Struktura e ndërtimit të shoqërisë. Lista e personelit sipas profilit (në përputhje me veprimtarinë për të cilën kërkohet licenca).

Do të njoftohet subjekti, që në bazë të nenit 11, pika 1, të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike*”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Power and Gas Operations” sh.p.k, në veprimtarinë e Tregëtimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**